



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Plus Trade LLC" të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Plus Trade LLC" të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Plus Trade LLC" (tutje "parashtruesi") me datë 04.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë si vijon:

OE i rekomanduar për Lot 2

P1 -

Deklarata ne betim nuk eshte plotesuar sipas kerkeses, pasi qe as nenshkrimi e vula nuk jane te vendosura apo te nenshkuara dhe vulosura ne vendin e dizajnuar sipas deklarates ne betim. Gje qe, ne formen e dizajnit dhe kerkeses e cila eshte pika kryesore, plotesimi i kesaj deklarate nga Partneri i vetem i INFINIT LIGHTING duhet te jete i papranueshem.

P2 -

Duke i'u referuar pikës 2, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, është kërkuar të paraqitet katalogu original ose kopje ,me specifikat teknike, andaj nese vleresohet katalogu me specifikat e kerkuara, lloji i propozuar nuk permbush kriteret e jetegjatesise pasi eshte kerkuara 100.000hrs, ndersa sipas specifikave te paraqitura jane 50,000hrs.

P3 -

Forma e plotesimit te ankesit nga OE, e cila nuk permbush kriterin.

Aneksi 7. LISTA E Pajisjeve

P4-

OE e rekomanduar per dheni te kontrates ne paramasen e saj ne kategorine I ka keto pozicione te gjitha me cmime te jo normalisht te uleta:

OE i rekomanduar për Lot 3

P5-

Duke i'u referuar pikës 11, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, është kërkuar të paraqitet pajisjet I obligueshem sipas tabelës, ndersa, sipas OE tabela nuk eshte preznetuar sipas kerkeses, poashtu Mjeti me targa JRL-140 eshte me skadence dhe detajet sipas kerkesave te ketij aneksi 7.

P6-

Forma e plotesimit te aneksit 7 nga OE, e cila nuk permbush kriterin.

Annex 7. LIST OF EQUIPMENT

P7-

Lista e prezentuar sipas OE, eshte vetem nje kontrate e cila ka vleren 425,395€, andaj nuk permbushet kushti kryesor per vleren per keto kontrata, gjersa dy kontrata e prezentuara jane jashte kohes te parapare nga data e njoflimit te kontrates.

P8-

OE e rekomanduar per dheni te kontrates ne paramasen e saj ne kategorine I ka keto pozicione te gjitha me cmime te jo normalisht te uleta:

OE i rekomanduar për Lot 4

P9-

Duke i'u referuar pikës 11, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, është kërkuar të paraqitet qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale, nders OE ka paraqitur per 4 vite, andaj nuk mund te konfirmohet se sa eshte vlera e sakte e qarkullimit per vitet 2021-2022-2023.

Ne mungese te informates s eskate, konludohet qe nuk permbushet ky kriter, pasi nuk eshte prezentuar sipas kerkeses ne FTD-se.

P10-

OE e rekomanduar per dhenie te kontrates ne paramasen e saj ne kategorine I ka keto pozicione ta gjitha me cmime te jo normalisht te uleta:

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Nuk është plotësuar kërkesa e DT lidhur me katalogun. Po ashtu nuk është plotësuar as kërkesa lidhur me certifikatat ISO.

Sa i përket pretendimeve ankimore – duhet cekur se të gjitha pretendimet ankimore janë drejtuar kundër tenderuesve të tjerë, përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Përderisa parashtruesi vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Përndryshe duhet shtuar edhe faktin që parashtruesi për të gjitha lotet ka ofertuar me çmim dukshëm më të lartë (pothuajse dyfish më të lartë) sesa tenderuesit e rekomanduar. Prandaj në rastin hipotetik më të favorshëm për parashtruesin, sërish parashtruesi në rast të rivlerësimit nuk do të mund të shpallej si tenderues i suksesshëm për shkak të çmimit më të lartë në krahasim me secilin nga tenderuesit e tjerë të rekomanduar për lotet përkatëse.

Megjithatë duhet cekur se tenderuesit e rekomanduar për kontratë për lot 2, 3 dhe 4, secili prej tyre ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e DT. Në fakt ofertat e tenderuesve të rekomanduar janë të vetmet oferta të përgjegjshme me çmimet më të lira. Prandaj rekomandimet për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues janë në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport

me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara. Pretendimi nr. 1, 3 dhe 6 janë pretendime të pasakta sepse formularët përkatës janë plotësuar në mënyrë plotësisht të saktë. Pretendimi 4, 8 dhe 10 janë të pasakta sepse AK ka analizuar çmimet e tenderuesve të rekomanduar në kuptim të nenit 41 të RRPP dhe në këtë mënyrë ka konstatuar se çmimet e tyre nuk janë aspak jonormalisht të ulëta. Pretendimet 5, 7 dhe 9 janë të pasakta pasi që tenderuesit e rekomanduar kanë dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare të kërkuara sipas dosjes së tenderit ndërsa pretendimi 2 përbën devijim të vogël të lejuar sipas LPP. Pra të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.09.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.